

DITURIA

E PËRKOHËSHME SHQIPËTARE

Del një herë në muaj

DREJTONJËS: LUMO SKENDO

MBAN:

*Shqipëtarët në Greqi — Aktiviteti i Shqipëtarëve në Rumani —
Disa dokumenta historike mbi Ali pashë Janinën — Tribunë gramatike dhe
gjuhësije — Fjalor për skaja dhe fjalë që kan' nevojë të kthiellohen —
Bibliografi shqipëtare — Libra të marra.*

TIRANË
LIBRARIJA LUMO SKENDO
1927

I dashur Këndonjës,

Kur vendosa të botonj DITURINË desha më parë të siguronj jetën e saj materiale; dhe, që të kupëtonj sa pajtimtarë do të kemí, pra sa të holla do të më vijnë, dërgova grishimin nek atá zotërinj që e kupëtonja se do të interesohen ne botimi i një reviste së fillë. Grishimet na u-kthyenë të nënëshkruarë prej miqvet t'anë.

Kur pashë se numuri i nënëshkrimtarëvet ishte i mjaftë, fillova shtypjen e së përkohëshmesë. Sot jemi ne numuri i tretë.

Mjerisht, prej atyreve që me dhanë fjalën dhe nënëshkrimin, më e shuma ka neglizhuarë të na dërgojë pajtimin.

Gjyshërit t'anë e kishin zakon të mbajnë *besën* vetëm me një fjalë. Kujtonja se një fjalë e dhënë me nënëshkrim, do të ishte një besë më e fortë.

Në goftë se vazhdon mos kujdesja, kam frikë se DITURIJA do të mbetetë pa dalë. Më vjen keq të parashoh ketë fatkeqësi, dhe më pëlqen të besonj së vonimi i atyneve që na dërguan nënëshkrimin e tyre, do të marrë një funt.

Si do që të jetë po bënj edhe një thirje të mrame: Ata që duanë të pagojnë pajtimin e tyre le të na e dërgojnë. Ata që janë penduarë dhe s' duanë të pagojnë, le të na kthejnë numuret 1 dhe 2 të Diturisë. — Këtë lutje të fundit po e bënj me insistencë, se, në mos më ktheshin këtë numure, nukë munt të bënj as pajtimtarë të rinj.

Më duket se kam të drejtë të bënj këtë lutje dhe shpresonj, të dashurë këndonjës, që nukë do të m' a refuzoni.

DITURIJA

